Siguri

# Tragjike | Vetëvrasje në Piranë të Prizrenit – gruaja gjendet pa shenja jete pranë armës

Sinjali.com 01 Maj 2026 20:54

**Një rast i rëndë ka ndodhur në fshatin Piranë të Prizrenit, ku një grua është gjetur pa shenja jete, mëson Sinjali.**

Ngjarja është raportuar sot, rreth orës 12:05, nga bashkëshorti i saj, i cili ka njoftuar Policinë se gruaja e tij dyshohet të ketë kryer vetëvrasje.

Njësitë policore kanë dalë menjëherë në vendngjarje, ku kanë hasur në viktimën L.A., rreth 43-vjeçare, ndërsa ekipi mjekësor ka konstatuar vdekjen e saj.

Sipas informacioneve fillestare, pranë trupit është gjetur edhe një armë zjarri, e cila dyshohet të jetë përdorur nga viktima.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitet e hetimeve të stacionit dhe hetuesit rajonalë, të cilët kanë siguruar vendin dhe kanë nisur ekzaminimet.

Rasti është iniciuar si “Hetim i vdekjes”, ndërsa për detaje shtesë pritet raporti i mëtejmë nga autoritetet kompetente.

***Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!***

**/GazetaSinjali/**

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



All rights are reserved 2025, Copyright Sinjali.com